



Albert Bekaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
BORDI ADMINISTRIMIT

Nr. 1833 / Prot.  
5

Vlorë më, 21.11.2022

VENDIM  
Nr. 39, datë 21.11.2022

PËR  
HAPJEN DHE MIRATIMIN E TARIFËS SË SHKOLLIMIT TË PROGRAMIT TË  
PËRBASHKËT TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE "MARITIME  
ENVIRONMENTAL PROTECTION AND MANAGEMENT (MEP&M)"

Në mbështetje të nenit 3, pika 3, gërma ç, nenit 49, të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 25 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Udhëzimit nr.1, datë 14.04.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar, si dhe referuar propozimit të Departamentit të Shkencave Detare ardhur me shkresën nr.495 prot, datë 08.11.2022, propozimit të Zv.Rektorit Akademik shkresa nr.1747 prot, datë 11.11.2022, shkresës së Administratorit nr.1748/1, datë 14.11.2022 miratuar me Vendim nr.46, datë 14.11.2022 të SA, Bordi Administrimit në mbledhjen e datës 21.11.2022,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Departamentit të Shkencave Detare, Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore për hapjen e programit të përbashkët të studimit Master i Shkencave "Maritime Environmental Protection and Management (Mep&M)"
2. Të miratojë tarifën për programin e ri të përbashkët të studimit Master i Shkencave "Maritime Environmental Protection and Management (Mep&M)" si më poshtë:

Emërtimi i programit	Kreditet e programeve të ciklit të dytë të studimeve	Tarifa për kredite në një program të parë ciklit të dytë të studimeve	Tarifa e shkollimit për një program të parë të ciklit të dytë të studimeve	Tarifa për kredite në një program të dytë të ciklit të dytë të studimeve	Tarifa e shkollimit për një program të dytë të ciklit të dytë të studimeve
Program master Shkencor "Maritime Environmental Protection and Management (MEP&M)"	120	1100	132,000	1320	158,400

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele  
Tel. Fax ++355222288

Web-site: www.univlora.edu.al  
email: info@univlora.edu.al





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
BORDI ADMNISTRIMIT

3. Masa e financimit të plotë gjatë gjithë kohëzgjatjes së programit do të mbulohet nga Buxheti i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori dhe Drejtorja e Shërbimeve Mbështetëse në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Sotir NIKOLLA**